



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 616/2 Prot

Tiranë, më 23/03 2012

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, “**Tirana-Urban-Trans**”
Tiranë.

VENDIM

Nr. 05, datë 23/03/ 2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Tirana-Urban-Trans**”, me adresë: Rruga: Abdi Toptani, Nr.5, pranë Bar “Rubini” Tiranë.

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësini për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të mësipërm parashikohet : “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana jonë, me shkresën nr.772 prot, datë 25.05.2010, ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi, datë 24.06.2010. Kjo shkresë është dërguar nëpërmjet shërbimit postar dhe nuk rezultoi e kthyer nga kjo e fundit.

Gjatë kontrollit administrativ të realizuar pranë kontrolluesit në zbatim të urdhërit nr 40, datë 09.03.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u konstatua se:

Kontrolluesi, “**Tirana-Urban-Trans**“, Tiranë nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nuk është zbatuar, neni 21 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kjo, ju bë me dije edhe kontrolluesit nëpërmjet procesverbalit të datës 16.03.2012 të mbajtur në prani të tij.

Nga kontrolluesi nuk u provua në mënyrë bindëse që shkresa sensibilizuese e sipërcituar nuk është marrë në dorëzim. Shërbimi postar “ **Posta Shqiptare**” sh.a nuk e ka kthyer këtë shkresë, cfarë ligjërisht reflekton që kjo shkresë është marrë nga një përfaqësues i kontrolluesit. Barra e provës për të vërtetuar të kundërtën i takon kontrolluesit.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” është ligj i cili është botuar në Fletore Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës ligjërisht supozohet se është bërë i njohur për gjithë publikun dhe është ligjërisht i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjithë kontrolluesit, institucionet publike dhe private të cilëve iu drejtohet.

Nga miratimi i ligjit deri në momentin e inspektimit administrativ në zbatim të urdhërit nr.40, datë 09.03.2012 ka kaluar një periudhë, relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka patur të gjithë kohën e nevojshme për tu njohur me ligjin dhe detyrimet ligjore të tij.

Në bazë të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shkak të mos njoftimit të përpunimit/ve që kontrolluesi realizon, mund të ketë penguar referencat e mundshme që subjektet specifike që u përpunonohen të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/ve që realizohen.

Mospërbushja e këtij detyrimi ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma “d”, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, neneve 107-109 të K.Pr.Administrative dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë 20.000 (njëzetë mijë) lekë për mosplotësimin e detyrimit për njoftim sipas nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm që ju ngarkon ligji, të kryhet brenda një afati kohor prej 7 (shtatë) ditësh.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot më datë, 23.03.2012.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (Pogaçe)





REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 616/5 Prot

Tiranë më, 27/04 2012

Lënda: Kthim- përgjigje.

Drejtuar: **Tirana Urban Trans sh.p.k**
Rruga: Abdi Toptani, Nr. 5, Tiranë

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet Drejtorisë së Hetim- Inspektimit ka marrë në shqyrtim ankesën tuaj, administruar pranë KMDP me Nr. 614/4 prot, datë 09.04.2012 me objekt: Kërkesë për rishikim vendimi.

Komisioneri e trajtoi ankesën tuaj me vëmendje, mbështetur në kërkesat e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe ju bën me dije si më poshtë:

Ju si kontrollues në kuptim të ligjit të sipërcituar keni detyrimin ligjor për njoftim(neni 21). Nga ana Juaj deri në momentin e marrjes së vendimit për gjobë Nr. 616/3 prot, datë 23.03.2012 nuk është plotësuar ky detyrim.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana jonë, me shkresën nr.772 prot, datë 25.05.2010, ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi, datë 24.06.2010. Kjo shkresë është dërguar nëpërmjet shërbimit postar dhe nuk rezulton e kthyer nga kjo e fundit.

Sic ju është bërë me dije edhe nëpërmjet vendimit Nr. 616/3 prot, datë 23.03.2012 nga ana Juaj nuk u provua në mënyrë bindëse që shkresa sensibilizuese e sipërcituar nuk është marrë në dorëzim. Shërbimi postar “ **Posta Shqiptare**” sh.a nuk e ka kthyer këtë shkresë, çfarë ligjërisht reflekton që kjo shkresë është marrë nga një përfaqësues i kontrolluesit. Barra e provës për të vërtetuar të kundërtën i takon kontrolluesit. Për më tepër kjo shkresë nuk është një detyrim ligjor për tu dërguar nga ana e Komisionerit.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” është ligj i cili është botuar në Fletore Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës ligjërisht supozohet se është bërë i njohur për gjithë publikun dhe është ligjërisht i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjithë kontrolluesit, institucionet publike dhe private të cilëve iu drejtohet.

Nga miratimi i ligjit deri në momentin e inspektimit administrativ në zbatim të urdhërit nr.40, datë 09.03.2012 ka kaluar një periudhë, relativisht e gjatë dhe ju keni patur të gjithë kohën e nevojshme për tu njohur me ligjin dhe detyrimet ligjore të tij.

Përsa i përket pretendimit të parashtruar nga ana juaj, se përjashtoheni nga detyrimi për njoftim sepse nuk përpunoni të dhëna personale, Komisioneri ka verifikuar dhe sipas Formularit të Njoftimit të plotësuar nga ana Juaj me nr. 1041 prot, datë 17.04.2012 ju keni deklaruar se përpunoni të dhëna personale të kategorisë sensitive që kanë lidhje me shëndetin.

Në këto kushte, sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” dhe VKM nr. 1232, datë 11.02.2009, pika 1/b “ Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave që përpunohen” fakti që ju përpunoni të dhëna sensitive në lidhje me shëndetin, e bën të detyrueshëm njoftimin pranë Komisionerit(neni 21).

Sa më sipër, Komisioneri nuk mund të marrë parasysh dhe miratoj kërkesën Tuaj për rishikimin e Vendimit të gjobës, Nr. 616/3 prot, datë 23.03.2012.

Faleminderit për mirëkuptimin.

KOMISIONERI

Flora CABEJ (Pogaçe)

